

**Tiranë, më 11.10.2021**

### **Njoftim për shtyp**

Komisioneri Publik ishte sot i pranishëm në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, ku vijoi shqyrtimi gjyqësor i ankimit kundër vendimit nr. 286, datë 4.8.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Genti Shala, magjistrat/gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

Kolegji i Posaçëm i Apelit, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, vendosi:

- 1. Lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, nr. 286, datë 4.8.2020, që i përket subjektit të rivlerësimit Genti Shala.*
- 2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.*

*U shpall sot, në Tiranë, më datë 11.10.2021.*

Mbështetur në pikën 1, të nenit 16, të rregullores së Institucionit të Komisionerëve Publikë, ankimi dhe parashtrimet janë publikuar në faqen zyrtare të këtij institucioni: <http://ikp.al/ankime/>

Institucioni i Komisionerëve Publikë është ngritur dhe funksionon në bazë të nenit 179/b dhe aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Komisionerët Publikë përfaqësojnë interesin publik gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.